



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Analizë teksti e Gjuhës B (2)

Ngarkesa: 6 kredite (= 60 orë)
Viti / Semestri : Viti I ,semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor, Gjuhë Angleze
Kodi i etikës: Kodi i etikës i Ut-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të zhvillojë më tej kompetencat komunikuese të studentëve në gjuhën angleze përmes integritit të katër aftësive: dëgjim, të folur, lexim dhe shkrim. Të pasurojë fjalorin dhe zotërimin e strukturave gramatikore nëpërmjet analizës së teksteve me gojë dhe me shkrim. Të nxisë autonominë dhe strategjitë personale të të nxënit, duke promovuar pjesëmarrjen aktive në veprimtari ndëraktive.

Objektivat specifikë lëndorë:

1. Të zhvillojë aftësitë e leximit të teksteve të ndryshme përmes parashikimit, skanimit, skimming dhe interpretimit të ideve kryesore.
2. Të përforcojë aftësitë e të shkruarit, duke u përqendruar në planifikimin, redaktimin, përdorimin e drejt të pikësimit dhe drejtshkrimit.
3. Të pasurojë fjalorin dhe përdorimin funksional të gjuhës, përfshirë sinonime, antonime, shprehje frazeologjike dhe formimin e fjalëve.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë të aftë të kuptojnë dhe të interpretojnë tekste të ndryshme të zhanreve të ndryshme, duke identifikuar ide, qëndrime dhe detaje.
2. Do të prodhojnë tekste të qarta dhe koherente, si ese, letra, përmbledhje dhe artikuj mbi tema të ndryshme, duke përdorur strukturë dhe gjuhë të përshtatshme.
3. Do të komunikojnë në mënyrë të kuptueshme në situata të përditshme dhe akademike, duke shprehur pikëpamje, përshkrime dhe mendime për tema personale dhe të përgjithshme.